STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 6 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ANALIZE TE PRAKTIKAVE TE BANKAVE PER HIPOTEKAT PAS SENDIT (SANDY)

Veprimi pason ankesat se pasi lejuan pronarët e shtëpive që të kapërcenin pagesa të hipotekave për shkak të vështirësive nga stuhia Sendi (Sandy) disa banka janë duke kërkuar ripagesë të menjëhershme të plotë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) është duke filluar një analizë të praktikave të bankave dhe agjencive të hipotekave për të përcaktuar nëse pronarët e shtëpive të goditur rëndë nga super stuhia Sendi (Sandy) që u lejuan të mos paguanin pagesa të hipotekave po ngarkohen tani padrejtësisht duke iu kërkuar të japin të gjitha pagesat e kaluara në ripagime të shumave të mëdha të menjëhershme. Departamenti është duke u kërkuar bankave që të lejojnë më shumë kohë që pronarët e shtëpive të bëjnë pagesat dhe është duke kontrolluar nëse bankat kanë realizuar premtimin e tyre për të mos përdorur pagesat e vonuara për të filluar procedimet e rimarrjes ose për të mos dëmtuar vlerësimin e kredisë të pronarëve të shtëpive.

Departamenti siguroi marrëveshje në nëntor dhe dhjetor nga bankat dhe agjencitë kryesore duke premtuar që të ofronin falje nga pagesat e hipotekave për disa pronarë të shtëpive në vështirësi për të bërë pagesat e tyre si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy). Bankat pranuan të lejojnë këtë pronarë të shtëpive që të mos bënin pagesat për tre deri në gjashtë muaj dhe pa kërkuar pagesa të mëdha në fund të periudhës së faljes. Bankat dhe agjencitë gjithashtu ranë dakort se vlerësimet e kredisë të pronarëve të shtëpive nuk do të ndikoheshin negativisht.

Tani që periudhat fillestare tre mujore te heqjes dorë janë duke skaduar, Departamenti është duke marë njoftime nga disa pronarë të shtëpive që thonë se janë duke iu kërkuar për pagesa të mëdha. Përveç kësaj, disa pronarë të shtëpive thonë se janë duke marë njoftime të procedurës përpara rimarrjes së shtëpisë mbështetur në pagesat e pabëra gjatë periudhës së faljes dhe po njoftohen tek agjencitë e kredive për pagesa të pabëra.

“Shumë banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) u goditën rëndë nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe nuk mund të paguanin faturat e tyre për shkak të të ardhurave të humbura, shpenzimeve të riparimit të shtëpive ose kostove të rivendosjes, kështu që bankat ofruan ndihmë për pronarët e shtëpive në formën e faljes së pagesave të hipotekave,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). ”Do të jetë e pallogjikshme që të ofrohet ajo ndihmë dhe tani të priten pagesa të shumave të mëdha nga pronarët e shtëpive me vështirësi financiare. Një pronar shtëpie që mund të mbledhë tre muaj të pagesave të hipotekës së bashku mbase nuk kishte nevojë për faljen pikë së pari. Të gjithë të tjerët kanë nevojë për më shumë kohë për të ripaguar.”

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services), tha, “Jemi duke hetuar për të përcaktuar nëse ankesat që kemi marë janë raste të izoluara ose pjesë e një prirje shqetësuese. Bankat nuk mund të thonë thjesht se do të ndihmojnë pronarët e shtëpive të dëmtuar nga Sendi (Sandy), ato duhet t’a bëjnë këtë.”

Në letrat drejtuar institucioneve, Kryeinspektori kërkoi informacion mbi numrin e pronarëve të shtëpive që kërkuan dhe morrën faljen, policat dhe praktikat e huadhënësve në lidhje me faljen, mënyrën sesi institucionet zbatuan faljen brenda institucionit dhe nëse do të shqyrtojnë ofrimin e faljes së shumës fillestare dhe pagesave të interest për deri në 12 muaj pas stuhisë dhe në cilat rrethana.

Në sondazhine tij, Departamenti është duke u kërkuar bankave dhe agjencive të hipotekave që t’ia japin informacion Departamentit deri në 12 mars. Informacioni specifik që Departamenti po kërkon përfshin:

- Menyrën sesi huadhënësit ndryshuan procesin e tyre të brendshëm që pronarët e shtëpive që marrin falje nuk do të marrin deklarata të klientëve me gabime ose njoftime të procedurës përpara rimarrjes dhe nuk do të njoftohen se janë me vonesë në pagesa pranë agjencive të kredisë.
- Nëse institucionet u siguruan një përshkrim me shkrim të kushteve të faljes huamarrësve.
- Veprimtarinë e rimarrjes dhe të përpara rimarrjes të kryer ose të pezulluar nga institucionet gjatë periudhës së fajles.

Pronarëve të shtëpive që marrin pjesë në programe të faljes, si dhe të gjithë pronarëve të tjerë të shtëpive me pyetje mbi bankat ose sigurimin që kanë lidhje me stuhinë, u bëhet thirrje të vizitojnë një Qendër të Ndihmës për Katastrofën (Disaster Assistance Center) që ka personel të Departamentit ose t’i telefonojnë linjës së Departamentit mbi stuhinë. Qendrat e ndihmës janë të renditura në faqen në internet të Departamentit, www.dfs.ny.gov. Linja telefonike mbi stuhinë, (800) 339-1759, ka personel nga ora 8 në mëngjes deri në 8 të pasdites, të hënën deri të premten dhe nga ora 10 në mëngjes deri në 5 të pasdites të shtunën dhe të dielën.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian